



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

PML.nr.3/2025

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përberë nga gjyqtarët Rasim Rasimi, kryetar, Mejreme Memaj e Agim Maliqi, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të dënuarit Nazmi Dushi, nga P., rruga "...", nr..., për shkak të veprës penale grabitje, parashikuar me nenin 317 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën e mbrojtëses se të dënuarit për mbrojtje të ligjshmërisë, avokates Elena Dragusha, paraqitur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.350/2023 datë 2 maj 2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me 25 shkurt 2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtëses se të dënuarit Nazmi Dushi për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.350/2023 datë 2 maj 2024.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.350/2023 datë 2 maj 2024, i dënuari Nazmi Dushi për veprën penale të grabitjes, parashikuar me nenin 317 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK, është gjykuar me pesë (5) vjet burgim, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 2 maj 2024 e tutje, dhe dënim me gjobë në shumë prej njëmijë (1000)€. Nëse i dënuari nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë apo nuk dëshiron në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së i njëjti do t'i zëvendësohet me burgim ashtu në një ditë burgim do t'i llogariten 20€ të gjobës. Me të njëjtin aktgjykim konform nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së është liruar nga akuza për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPP.

Në procedurën ankimore sipas ankesës së Prokurorit dhe mbrojtëses se të dënuarit aktgjykimi i lartcekur është vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PAKR.nr.423/2024 datë 6 shtator 2024.

Kundër aktgjykimeve të lartcekura në pjesën dënuese ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtësja e të dënuarit avokatja Elena Dragusha, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që kërkesa të aprovohet aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i dënuari të shpallet fajtor për veprën penale grabitje, parashikuar me nenin 317 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe ndaj tij të shqiptohet një dënim me i butë.

Prokurori i Shtetit me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.1/2025 datë 15 janar 2025, ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoj pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa nuk është e bazuar.

Në kërkesë mbrojtësja e të dënuarit pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, parashikuar nga neni 384 par.1 nenpar.1.8 e 1.10 të KPP-së, për shkak se në arsyetimin e aktgjykimeve nuk janë paraqit arsye për çdo pikë të aktgjykimit, që ka të bëjë me dënuarin Nazmi Dushi, kjo për faktin se të dy gjykatat kanë konstatuar se i dënuari nuk ka pasur armë, kurse sa i përket të pandehurit tjetër ka mbet e pasqaruar për shkak se i njëjti është në arrati, dhe nuk kanë paraqitur arsye në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsiderojnë të vërtetuara apo të pavërtetuara. Nuk janë dhënë arsye përkitazi me saktësinë e provave kundërthënëse dhe arsye në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjes juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarit, kur kihet parasysh fakti se veprimet që përshkruhen në dispozitiv nuk vërtetojnë se i njëjti ka pas armë apo se ka përdor dhunë apo kanosje ndaj palëve të dëmtuara, e kjo e bën të paqëndrueshëm edhe kualifikimin e veprës penale.

Sipas mbrojtëses në rastin konkret është shkëlur edhe ligji penal në dëm të dënuarit, sepse në veprimet e tij nuk përmbushen elementet e figurës së veprës penale, grabitje në bashkëkryerje, nga neni 317 par.3 lidhur me par.1 e 31 të KPRK-së, ngase i dënuari nuk ka pas armë, kurse edhe i pandehuri tjetër nga video incizimet nuk del qartë se ka pas armë, ndërsa, përdorimi i armës është element qenësor i kësaj vepre penale.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet në kërkesë janë të pabazuara. Se pari, mbrojtësja edhe pse i kundërshton aktgjykimet për shkelje esenciale, nga neni 384 par.1 nenpar.1.8 e 1.10 të KPP, nuk jep arsye se në çka konsistojnë këto shkelje, përveç që parafrzohet dispozita ligjore se “gjykatat nuk ka dhen arsye për çdo pikë të aktgjykimit, për faktet vendimtare dhe saktësinë e provave kundërthënëse”, kurse nga arsyetimi i kërkesës del qartë se kundërshtohet zbatimi i ligjit penal, sepse kontestohet cilësimi i veprës penale për të cilën është shpall fajtor, e që të njëjta pretendime i referohen edhe shkeljes së ligjit penal.

Megjithatë, kjo Gjykatë i shqyrtojë aktgjykimet nëse janë të përfshira me shkelje esenciale te cekura në kërkesë dhe gjeti se nuk qëndrojnë pretendimet e mbrojtëses. Në fakt aktgjykimi i shkallës së parë i cili është vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë është përpiluar konform dispozitës së nenit 369 të KPP. Në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë në mënyrë të qartë theksohet mënyra e kryerjes së veprës penale, kurse në arsyetim janë dhënë arsye për të gjitha faktet vendimtare jo vetëm sa i përket përgjegjësisë penale të dënuarit por edhe lidhur me ekzistimin e veprës penale për të cilën është akuzuar dhe shpall fajtor i dënuari. Gjykatat në pajtim me dispozitën e lartcekur kanë paraqitur arsye për çdo pikë të aktgjykimit, kanë vlerësuar provat e administruara si ato materiale dhe jo materiale, dhe mbrojtjen e të

dënuarit, dhe kanë dhënë arsye se cilës provë ia kanë falë besimin dhe cilës jo, të cilat si të drejta i ka aprovuar edhe gjykata e shkallës së dytë dhe si të tilla i aprovon edhe kjo gjykatë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate edhe pretendimet e mbrojtëses për shkelje të ligjit penal nuk janë të bazuara. Në fakt pretendimet e mbrojtjes së në veprimet e të dënuarit nuk përmbushen elementet e veprës penale të grabitjes, nga neni 317 par.3 të KPRK, janë të pabazuara për këto arsye:

Bazuar në provat e administruara dhe aktgjykimet e kundërshtuara rezulton qartë së vepra penale e grabitjes është kryer në bashkëkryerje (kjo nuk mohohet as nga i dënuari). Po ashtu rezulton se i dënuari sipas marrëveshjes paraprake me të pandehurin Deniz Torbanqe i cili është në arrati është futur në lokalet e bankës dhe nën kërcënimin e armës të cilën e ka poseduar i pandehuri Deniz i kanë marr nga punëtoret e bankës shumën e parave të cekura në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Pra, meqë vepra penale është kryer në bashkëkryerje dhe nën kërcënimin e armës bëhet fjalë për formën kualifikuese të kësaj vepre penale nga par.3 i nenit 317 të KPRK-së, kurse është irelevant fakti se i dënuari nuk kishte në posedim armë. Kjo për faktin se për ekzistimin e bashkëkryerjes duhet të shprehet elementi subjektiv i cili konsiston në vendimin e përbashkët për kryerjen e veprës penale (i cili element është vërtetuar në bazë të pranimit të nga i dënuari) dhe kryerja e veprës penale se bashku. Kurse, kryerja e veprës penale sipas dispozitës ligjore të nenit 31 të Kodit Penal shprehet në dy situata: kur dy apo më shumë persona se bashku ndërmarrin veprimin e kryerjes së veprës penale, dhe në rastet ku personi tjetër thelbësisht kontribon në kryerjen e veprës penale, e që në rastin konkret vjen në shprehje situata e dytë. Meqë këto pretendime kanë qenë objekt shqyrtimi nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, për cilat kanë dhënë arsye të qarta dhe të drejta, si të tilla i mbështet edhe kjo gjykatë, dhe nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësime në këtë drejtim.

Kjo gjykatë vlerëson se pretendimet në kërkesë nuk e vejnë në dyshim gjendjen e fakteve dhe aplikimin e ligjit penal, pra, konkludimet e gjykatave se në veprimet e të dënuarit manifestohen elementet e veprës penale, grabitje, parashikuar me nenin 317 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, janë të bazuara..

Për arsyet e cekuar më lartë kërkesa u refuzua si e pabazuar, kurse në kuptim dispozitës së nenit 437 të KPP vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**

Pml.nr.3/2025, me 25 shkurt 2025

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Rasim Rasimi